RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*
Blerina Huruglica Eksperte Shqyrtuese	26.04.2022	29.04.2022	*112/22*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 22.04.2021 **OE "Pro Medical"SHPK ,** ka parashtruar ankesë me nr. **112/22** kundër njoftimit mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull:"**Furnizimi me pajisje mjekësore për përkrahje të komunalitetit RAE"**, me nr. të prokurimit: **206-20-5380-1-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Shëndetësisë.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 50 000,00 €

Data e njoftimit për kontratë.....16.09.2020.
Hapja e ofertave.....07.10.2020.
Data e njoftimit të vendimit të AK-së..(anulim).....13.04.2022.
Data e kërkesës për rishqyrtim.....14.04.2022.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesës për rishqyrtim.....22.04.2022.

Ankesa nuk është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: OE

Dispozitat e shkelura

Sipas dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik, nr.04/L-042
Neni 1 –Qellimi i ligjit;
Neni 2 Fushëveprimi;
Neni 7 –Barazia ne trajtim/jo-diskriminimi
Neni 38-Kontratat Publike Kornizë
Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit.
RrUOPP Neni 41-Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
RrUOPP Neni 44- Ndërprerja e procedurave të prokurimit
Neni 108/A si dhe Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave
Neni 6.

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Neni 1- Qëllimi -E kundershtojme vendimin e Autoritetit Kontraktues ngase i njejti është në kundërshti me nenin 1 te Ligjit per Prokurim Publik.
AK në këtë rastin tonë ka shkelur Nenin 1 paragrafin 2 të LPP citim *"Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji"*
Andaj AK duke anuluar këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me LPP dhe nuk ka pasur bazë sidomos Neni 62 dhe AK duke mos marr asnjë mundim që të përfundoj këtë aktivitet të prokurimit konfrom LPP dhe arsytimi i cekur në njoftimi e AK me datën 14.04.2022 në **B10 Njoftimi per anulimin e aktivitetit te prokurimit** me një arsytim jo valid dhe pa bazë ligjore.

Neni 2 Fushëveprimi-Në kundërshtim me nenin 2, pasi që ky nen përcakton qartë se gjatë ushtrimit të të gjitha aktiviteteve të prokurimit, autoritetet kontraktuese dhe koncensionerët janë të obliguar që të zbatojnë dhe respektojnë kërkesat procedurale dhe përmbajtësore të këtij ligji.

Neni 7 –Barazia ne trajtim/jo-diskriminimi-Në kundërshtim me nenin 7, pasi që, duke qenë se oferta jonë ka qënë më lirë dhe AK duke mos vazhdimin vlersimin konfrom RrUOPP Neni 41.2 , 41, 44 dhe Neni 62 LPP pra AK anulonon aktivitetin e prokurimit vetëm që të na mohoj të drejt ku ne si OE kemi mund të rekomandon për kontratë.

Neni 38 Kontratat Publike Kornizë pika 7 të LPP i citim "KRPP është e autorizuar dhe ka përgjegjësinë që të zhvilloj dhe shpallë rregullat dhe procedurat e nevojshme që qeverisin dhënien dhe përdorimin e kontratave publik " andaj AK me veprimin e vet dhe me justifikimin në mungesa e buxhetit nuk qëndron edhe AK ka mundur te bartë mjetet apo të kërkoj ri-shkimi te mjeteve finaciare apo të kërkoj mjete për këtë aktivitet të prokurimit por AK nuk ka marr mundim që të përfundoj këtë aktivitet të prokurimit konfrom LPP, pra AK ka bërë shkelje të këtij neni pas nuk është kompetence e AK për të përcaktuar rregullat dhe procedurat por kjo është përgjegjësi e KRPP.
AK ka qenë informuar lidhur me ketë aktivitet të prokurimit që nga fundi i vitit 2020 edhe ne si OE kemi derguar disa shkresa si ri-kujtim (shiko email si prove qe kemi derguar te AK te bashkangjiturë kesaj ankese) lidhur me ketë aktivitet të prokurimi por AK duke mos vepruar edhe duke mos respektuar LPP kemi dyshime se ka pasur si qëllim që anuloni këtë tender dhe ne mohoj te drejtën që e parash LPP që ne kemi mundur të rekomandohemi për kontratë, AK ka mundur të siguroj mjetet finaciare në buxhetin ne viti 2021, ri-shikim te buxhetit ne vitin 2021 apo me planfikim ne buxhetin 2022 apo keni mundur te paraqesin kërkesë për mjete finacire gjate ri-shikimit të buxhetit edhe për vitin 2022 por mos veprimi i AK ne si OE jemi penalizuar nga AK.
Pretendimi ankimor është se AK ka anuluar akrivitetin e prokurimi në kundershtime me LPP.

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit -Në kundërshtim me nenin 62, i cili nen, specifikon vetëm dy (2) arsye se kur mund të përfundoj një aktivitet i prokurimit "pas hapjes së ofertave", dhe se asnjë nga arsyet e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimi, nuk gjen mbështetje në këtë nen.
Për ta ri-konfirmuar këtë e kemi edhe një interpretim ligjor në një situatë të ngjashme nga KRPP (shiko shkresën nga KRPP për Interpretim ligjor lidhur kur mund te anulohet një aktivitet i prokurimit), të cilin e gjeni të bashkangjitur në këtë ANKESË, i cili interpretim qartëson përtej çfarëdo dyshimi se përfundimi i një AK pas hapjes së ofertave mund të bëhet vetëm e vetëm duke u mbështet në nenin 62 të LPP. Pra AK duke neglizhuar këtë aktivitet të prokurimi a ka anuluar me arsytim se nuk ka mjete finaciare apo dicka te till por jo nuk qëndron sepse AK ka mundur të kerkoj mjete finacire gjate planfikimit, rishyrtim dhe alokimin e mjeteve por e ka neglizhur kete aktivitet dhe si rezulatat i mos veprim te AK ka anuluar AP ne kundershtim me LPP.

Neni 41-Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve i RrUOPP pra Nenin 41 - Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve te Rregullat dhe Udhezuesi Operativ per Prokurimin Publik e cila në menyre shume te kjartë e përcakton se citojme:
41.2 Procedura per ekzaminimin, vleresimin dhe krahasimin e tendereve do te kryhet nga AK brenda periudhes mete shkurter te mundshme kohore dhe jo me shume se 30 dite nga hapj a e ofertave. Vetem ne raste te j ashtezakonshme dhe te justifikuara, ne vecanti per kontratat e nje natyre komplekse, kjo periudhe mund te zgjatet per nje afat shtese prej 20 ditesh. Procesi i vleresimit te tenderit dote filloje menjehere pas perfundimit te procesit te hapjes se tendereve dhe jo me vone se 5 dite pas perfundimit te procesit te hapjes se tendereve"

Kurse AK nuk ka bërp fare Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve konfrom LPP dhe RrUOPP.
Neni 44- Ndërprerja e procedurave të prokurimit i RrUOPP - Në kundërshtim me pikën 44 pasi që, kjo pikë e RRUOPP specifikon qartë se kur mund të anulohet aktiviteti i prokurimit pas hapjes së ofertave, dhe se arsyetimi i anulimit, në vendimin/njoftimin nga AK i datës 14.04.2022 nuk është i bazuar në këtë pikë, pasi që arsyetimin e këtij vendimi nuk e gjejmë në arsyet që parashihen në këtë pikë të RRUOPP-së.
Po në këtë pikë precizohet saktë se kur AK mund ta anuloj aktivitetin e prokurimit duke u bazuar në arsyet e precizuara në këtë pikë.
RRUOPP (Pika 44) Ndërprerja e procedurave të prokurimit 44.6 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme:
(ii) të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK"

AK duke përdoror këtë praktike ne nje menyre bie deri ne abuzim me LPP, ku rrejshimish AK nuk do respektuar edhe Neni 7 edhe nje herit AK duke përdoror këtë praktike ne nje menyre bie deri ne abuzim me LPP.

Neni 108/A si dhe Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave Neni 6 pra AK duke mos Ri-shqyrtuar kërkesën tonë të datë 14.04.2022 bie ndesh me Neni *6.3 pra citim " Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në nenin 6.2 te këtyre rregullave. Ky afat, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë"*

VENDIMI

Aprovohet Ankesa si e bazuar e OE " Pro Medical"
Të Anulohet Vendimi i AK dhe ky AP të Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve konfrom LPP.

KRITERET PËR VLERËSIM

N/A

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Mungesa e buxhetit dhe skadenca e vlefshmeris se ofertave.

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE

Sqarim hyrës:

Aktiviteti i prokurimit me titull:"**Furnizimi me pajisje mjekësore për përkrahje të komunalitetit RAE"**, me nr. të prokurimit: **206-20-5380-1-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –**Ministria e Shëndetësisë.**

Është publikuar njoftimi për kontratë me datë **16.09.2020,** ku hapja e ofertave është bërë me datë **07.10.2020, kurse** proceduar dhe vendim i AK-së mbi anulimin publikohet me datë **14.04.2022.**

OE ankuesi pretendon se AK ka shkel nenet 1,2,7,38,62,108/A të LPP-së, neni 41 dhe 44 të Ruopp-së, duke përfunduar aktivitetin e prokurimit kundërligjshëm pas hapjes së ofertave.

Përgjigje në Pretendimin ankimor:

Ekspertja Shqyrtuese sqaron se, sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me neglizhencën e AK-së në vlerësimin e ofertave konsideroj se **gjendet i bazuar,** për faktin se ky aktivtet i prokurimit konform afateve ligjore të LPP-së dhe Rruopp-së po të ishte proceduar atëherë do të rezultonte në nënshkrim të kontratës para një viti.

Si përfundim, ky aktivitet i prokurimit si proces nuk është proceduar konform afateve ligjore të LPP_së dhe Rruopp-së, ku si pasojë e neglizhencës, pa-përgjegjësisë, mos-llogaridhënies, jo-transparencës së AK-së i cili ka shkelë të gjitha parimet e përcaktuara sipas LPP-së dhe Rruopp-së**, pëson operatori ekonomik**, dhe si rezultat konsideroj se ndaj AK-së duhet të merren masa ndëshkuese sipas proceduarve dhe rregullave në fuqi konform LPP-së dhe Rruopp-së.

Përderisa, sa i përket aktivitetit të prokurimit**,** nëse marrim në konsideratë emeregjencat si pasojë e Covid 19, dhe marrë parasyshë edhe kohën e tejzgjatur të kësaj procedure të tenderimit, konsideroj të mbetet në fuqi vendimi i AK-së si pasojë e mungesës së buxhetit, duke përfshirë edhe skadimin e validitetit të ofertave e cila ka rrjedhë nga neglizhenca e AK-së në mos dërgimin e kërkesës për zgjatje, dhe si e tillë konform LPP-së dhe Rruopp-së si dhe përgjigjes së Krpp-së në pyetjen 69 tek pyetjet e shpeshta, meqenëse oferta nuk posedon validitet dhe e cila nuk mund të vazhdohet në mënyrë retroaktive, po ashtu nuk mund të nënshkruhet kontrata me validitet të skaduar të ofertës, ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet.

Neni 31.3 i RRUOPP kërkon rreptësishtë që **oferta të ketë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi i kontratës**. Prandaj KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës.

Për këtë arsye, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. **Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohet zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit.**

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja Shqyrtuese i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ”Pro Medical ” të aprovohet si pjesërisht e bazuara, kurse vendimi i AK-së mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit të mbetet në fuqi.

Raporti i ekspertizës t’i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues	- Ministria e Shëndetësisë.
Panelit Shqyrtues	- OSHP
OE ankues	-“Pro Medical”SHPK